



Pranuar / Dorezuar Punijeno/Prodato Received/Delivery	17 - 12 2021	1	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SPANSIK	6221/2021		114



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.902/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Arben Mehmeti-anëtar dhe Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.902/2021 të datës 03.11.2021 të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit/Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 17.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET si e bazuar ankesa me numër A.nr.902/2021 e datës 03.11.2021, e parashtruar nga ankuesi

II. OBLIGOHET Udhëheqësi Ekzekutiv i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të tij, duke e përfshirë në listën e pagave sipas Vendimin Nr. 14/21 të datës 09.09.2021, dhe të bëjë kompensimin e diferencës së pagës së ndaluar.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi në bazë të Vendimit të datës 29.01.2018 është emëruar në pozitën Udhëheqës Ekzekutiv i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore me mandati tre (3) vjeçar. Përmes emalin Zyrtari Ligjor i KKT-së më datë 09.09.2021 ka njoftuar Zyrtarin e Personelit të këtij institucioni se për pozitën Udhëheqës Ekzekutiv i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, nuk do të ketë rekomandim për zgjatje të mandatit dhe do të procesohet me shpalljen e konkursit për pozitën në fjalë.

Njësia e Burimeve Njerëzore e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, bazuar në dispozitat e tyre të legjislativitetit për zyrtarët publik, më datë 09.09.2021 ka nxjerr Vendim me Nr. 14/21 me të cilin ankuesin e ka

emëruar në pozitë të mesëm drejtuese respektivisht Drejtor i Departamentit për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore Materiale në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore.

Ankuesi më datë 03.11.2021, ka parashtruar ankesë me Nr. Prot: 5268/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore që edhe pse jam emëruar në pozitën Drejtor i Departamentit për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore Materiale, paga është kualifikuar në nivel të ulët drejtues me koeficient nëntë (9).

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 05.11.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Këshillin e Kosovës për Trashëgimit Kulturore, ndërsa më datë 16.11.2021 kemi pranuar përgjigje në ankesë. Në bazë të provave të dërguar kemi konstatuar që ka mungesë të dokumentacionit dhe më datë 25.11.2021 kemi kërkuar prova shtesë ndërsa më datë 06.12.2021 kemi pranuar përgjigje shtesë lidhur me ankesën.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 03.11.2021 me Nr.Prot:5268/2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin e datës 29.01.2018 të Kryetarit të Bordit të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore; Kërkesën për sqarim e datës 27.01.2021 nga Zyrtari Ligjor i KKTK-së për ankuesin; Kërkesën për sqarim e datës 29.01.2021 nga Njësia e Burimeve Njerëzore e KKTK-së për Drejtorin e Departamentit Ligjore në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike; Emailin e datës 29.04.2021 nga _____ për _____ lidhur me kërkesën për sqarim; Emailin e datës 17.05.2021 nga _____ për _____ Raportin e Punës së Sekretariatit të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për periudhën 2018-21; Emailin e datës 09.09.2021 nga _____ për _____ Rregullores Nr. 01/2016 për Punën e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore e datës 12.05.2016; Formularin e shpenzimit të Departamentit, Divizionit ose Sketorit datës 24.09.2021 Emailin e datës 09.09.2021 nga _____ për ankuesin; Emailin e datës 09.09.2021 nga ankuesi për _____ Vendimin Nr.14.21 i datës 09.09.2021 i Njesisë së Burimeve Njerëzore të KKTK-së; Akt Emërimit e datës 09.09.2021; Listën e pagave në emër të ankuesit; Emailin e datës 01.11.2021 nga ankuesi për _____ Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 05.11.2021; Përgjigje në ankesë e datës 16.11.2021; Emailin e datës 01.09.2021 nga ankuesi për _____ Emailin e datës 01.11.2021 nga ankuesi për _____ Kërkesën për prova shtesë e datës 25.11.2021; Përgjigjen në përgjigje shtesë e datës 06.12.2021; Emailin e datës 12.11.2021 të _____ për _____ Emailin e datës 12.11.2021 nga _____ për _____ Strukturës Organizative të KKTK-së.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi që ka shqyrtuar të gjitha provat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit _____ është e bazuar sepse:

Bazua në provat e lëndës, emërimi i ankuesit në pozitën Udhëheqës Ekzekutiv i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore është bërë sipas Vendimit të datës 29.01.2018 me mandat tre (3) vjeçar deri më datë 28.01.2021, ndërsa pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarë Publikë në pajtim me nenin 83 paragrafin 6 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton që: *“Një nëpunës civil i kategorisë së lartë drejtuese në një institucion të administratës shtetërore, i emëruar në këtë pozitë sipas procedurës së Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, do të vazhdojë mandatin e tij/saj për kohën e mbetur të përcaktuar në Ligjin e Shërbimit Civil nr. 03/L-149 të Republikës së Kosovës”*, mirëpo ankuesi ka vazhduar ta ushtroj mandatin deri më datë 09.09.2021 duke pasur parasysh se nuk ka marr njoftim për mos vazhdim të mandatatit dhe njëherit Bordi i KKTK-së ka qenë jo funksional prandaj ankuesi ka vepruar edhe sipas opinionit ligjor të Ministrisë së Punëve të Brendshme të datës 17.05.2021 në të cilinë thuhet që: *“...Andaj nga kjo që u tha më lartë, gjithnjë në kuptim të dispozitave të lartcekura, nëpunësi civil i kategorisë së lartë drejtuese që e ka kryer mandatin e tij të parë duhet të vazhdojë t'i kryej detyrat e tij të punës deri sa nuk ka asnjë njoftim nga organi kompetent që nuk i vazhdohet mandati i tij i dytë”*.



Nisur nga fakti që Këshilli i Kosovës për Trashëgimit Kulturore është institucion i pavarur i cili i raporton Kuvendit të Republikës së Kosovës, dhe në bazë të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, konkretisht nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 është trajtuar si institucion tjetër shtetëror, i cili përcakton se: ***“Institucion tjetër shtetëror - është administrata e Kuvendit, administrata e Presidentit, administrata e një institucioni të sistemit të drejtësisë, e një institucioni të pavarur, e një agjencie të pavarur apo e një komune”***, kështu që Njësia e Burimeve Njerëzore e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore bazuar në dispozitat e nenit 42 paragrafit 7 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë më datë 09.09.2021 ka nxjerr vendim për caktimin e ankuesit në pozitën e mesme drejtuese e cila dispozitë përcakton se: ***“Me mbarimin e mandatit sipas paragrafit 4 apo 5 të këtij neni, për kandidatët e emëruar në kategorinë e nivelit drejtues nga Shërbimi Civil, Njësia e Pranimi detyrohet të emërojë nëpunësin të cilit i mbaron mandati në një pozitë të kategorisë së mesme drejtuese dhe pastaj në pozitë të kategorisë profesionale”***, dhe nenit 15 paragrafit 1 të Rregullores Nr.15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues, i cili përcakton se: ***“Pas përfundimit të mandatit të nëpunësit, DMZP për institucionet e administratës shtetërore dhe NJBNJ për institucionet tjera shtetërore e emëron nëpunësin në një pozitë të kategorisë së mesme drejtuese nëse ka të lirë një pozitë të fillë, e nëse nuk ka të lirë atëherë e emëron në një pozitë të nivelit më të lartë të kategorisë profesionale”***.

Duke iu referuar përgjigjes në ankesë të dërguar më datë 16.11.2021 nga Zëvendësuesi i Udhëheqësit Ekzekutiv të KTKK-së, i cili ka thënë që pozita Drejtor i Departamentit për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore Materiale në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore nuk ekziston, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në të gjitha provat e lëndës, ka konstatuar se në bazë të provave shtesë të dërguara nga Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore të datës 06.12.2021, respektivisht në bazë të Strukturës Organizative të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, konstatohet se pozita Departamenti për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore Materiale është paraparë si pozitë, po ashtu edhe në bazë të Raportit të Punës së Sekretariatit të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për periudhën 2018-2021, tek pjesa e Organizimit të Brendshëm të Institucionit respektivisht Ekzekutivi, konstatohet se Departamenti për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore Materiale është e paraparë si pozitë, andaj Njësia e Burimeve Njerëzore e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore me rastin e nxjerrjes së vendimit të datës 09.09.2021, ka vepruar në pajtim me kompetencat e përcaktuara me nenin 42 paragrafit 7 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 15 paragrafi 1 të Rregullores Nr.15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke i shqyrtuar provat e lëndës, ka konstatuar se edhe pse ankuesi është sistemuar në pozitën Drejtor i Departamentit për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore Materiale në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore, i njëjti në bazë të listës së pagave është paguar me koeficient nëntë (9) si nivel i ulët drejtues apo për pozitë të Udhëheqësit të Divizionit, në këtë rast është vepruar në kundërshtim me nenin 19 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: ***“Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer, si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave”***, bazuar në këtë Udhëheqësi Ekzekutiv i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore është i obliguar bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimi të tij, duke e përfshirë në listën e pagave sipas Vendimin Nr. 14/21 të datës 09.09.2021, dhe të bëjë kompensimin e diferencës së pagës.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.902/2021

Flakron GASHI

Procesmbajtës

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Zëvendësuesit të Udhëheqësit Ekzekutiv të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

